

Mbi
Auditimin e Brendshëm
Ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit
-në Bashkinë Shkodër

Njësia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkodër dhe Njësia Auditimit Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së Tirane bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr.114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ligjin nr.10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiare dhe Kontrollin”, ligjin nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, dhe akteve nënligjore për zbatimin e tyre, urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, zhvilluan një mision të përbashkët auditimi të kombinuar (për shërbimet e sigurisë) në Drejtorinë e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në Bashkinë Shkodër, për periudhen 01.01.2017 – 31.05.2018 nga auditimi rezultoi :

Përmbledhje ekzekutive:

Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në Bashkinë Shkodër funksionon në zbatim të ligjit nr.152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit” dhe një sërë aktesh nënligjore në zbatim të tij, dhe ka kaluar si institucion varësie i Bashkisë, me urdhër nr.13 dt.19.01.2016.

Gjatë auditimit janë konstatuar mangësi thelbësore në funksionimin e kësaj strukture, kryesisht në vendosjen e objektivave, në përshkrimin e proceseve të punës në kontrollin e aktiviteteve, në monitorimin dhe informimin si dhe në hartimin dhe ndjekjen e regjistrit të riskut, mangësi në menaxhimin e aktivitetit të institucionit. Mangësinë zbatimin dhe ndjekjen e procedurave prokuruese. Nuk ka patur bashkëpunim me drejtoritë pranë bashkisë Shkodër dhe institucionet e tjera për hartimin e regjistrit të objekteve/aktiviteteve për të ushtruar kontroll lidhur me masat e mbrojtjes nga zjarri. Mangësi të theksuara në sektorin e inspektim-parandalimit, në lidhje me zbatimin udhëzimeve të ministrit të Brendshëm lidhur me administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor që duhet të administrojë ky shërbim në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Auditimi u krye sipas programit për angazhim auditimi të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, nr.prot.2542/3, datë 26.06.2018 dhe nga Drejtorit i Shërbimit të MZSH-së në Ministrinë e Brendshme, nr.prot.1021/6 datë 27.06.2018.

Raporti Final i Auditimit u hartua mbi bazën e Projekt Raportit të Auditimit, i dërguar në njësinë e audituar me shkresë nr.13755 prot. dt.23.08.2018 dhe observimeve të dërguara në bashkinë Shkodër me shkresë nr.522 prot. dt. 17.10.2018. Pjesë e këtij raporti u bënë dhe gjetjet nga auditimi i kryer më parë nga Njësia e Auditimit e Bashkisë Shkodër pasqyruar në raportin final të auditimit nr.prot.14015, date 20.09.2017.

Observimet e dërguara nga njësia e audituar, megjithëse jashtë afateve ligjore dhe pa dokumente mbështetëse, u administruan, u analizuan nga grupi i punës dhe u trajtuan një më një. Observimet

e marra në konsideratë, që kishin argumente ligjorë u reflektuan në raport, ndërsa observacionet e tjera u sqaruan në aneksin bashkëlidhur Raportit Final të Auditimit nr.4, datë 25.10.2018.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të mëparshëm të auditimit.

Procedurat e vendosura dhe të ndjekura, për zbatimin efektiv të rekomandimeve të lëna, për të siguruar se veprimtaria e institucionit të audituar do të përmirësohet, pasi janë marrë masat korrigjuese për mangësitë, parregullsitë dhe shkeljet e vërtetuara, për mirëfunksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm ose arsyet e mosveprimit për marrjen e masave korrigjuese. Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.9720 dt. 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik“, i ndryshuar, pika 2, neni 9 të ligjit nr.10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” në raportin final të auditimit nr.14015 prot. dt. 20.09.2017, janë lenë 18 rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së drejtorisë së MZSH-së. Një pjesë e këtyre rekomandimeve janë zbatuar, një pjesë janë në zbatim e sipër dhe një pjesë janë ende të pazbatuara. Në gjetjet e pasqyruara në raportin përfundimtar të auditimit, sipas rubrikave të audituara janë vënë në dukje edhe këto realizime apo mosrealizime.

2. Kontrolli i brendshëm, vlerësimi i drejtimit dhe performanca.

Gjetje nr. 01 : Referuar neneve 4, 5,11 të ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Aneksive të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdherin e Ministrisë Financave nr. 108 datë 17.11.2016, Drejtoria e Përgjithshme MZSH-së Tirane, duhej të kishte hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të funksionimit. Drejtoria MZSH Bashkia Shkodër përgatitjen e planit vjetor të punës, përpilimin e hartës proceseve të punës, hartimin e regjistrit të riskut, planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, metodologjinë dhe liste kontrollet për vizitat në terren, planin kontrollit brendshëm, nga auditimi i kryer ka rezultuar se ka mangesi në përpilimin e rregullores brendshme dhe miratimin e saj, nuk janë hartuar plane vjetore, nuk është përpiluar harta e proceseve punës, ka mangesi në përpilimin e regjistrit të riskut, nuk është plani veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk janë përpiluar liste kontrollet për vizitat në terren.

Rekomandimi nr. 01: Pershtatjen dhe miratimin e rregullores së funksionimit në përputhje me shembullin 01 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdherin e Ministrisë Financave nr. 108 datë 17.11.2016.

Rekomandimi nr. 02: Përpilimin e planit vjetor të punës, përmirësimin e regjistrit të riskut, hartimin e plan veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përpilimin e liste kontrolleve për vizitat në terren.

Gjetje nr. 02 Ne refernce te neneve 9 dhe 12 te ligjit nr.10296 date 8.07.2010 “ Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” , i ndryshuar nepunesi Autorizues dhe zbatues duhej te kishin kryer funksionet menaxheriale, zbatuese, kontrolluese dhe raportuese, te dokumentuar.

Rekomandim nr. 03: Nepunesi Autorizues dhe nepunesi Zbatues te ushtrojne kontrollin e brendshem (te dokumentuar) ne te gjitha proceset e aktiviteteve per te ndihmuar ne kryerjen e veprimtarive te njesise publike

Gjetje: nr 03:Referuar neneve 9, 23,24, të ligjit nr.10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiare dhe kontrollin”, duhej te ishte kryer informimi i organeve eprore si dhe duhej te ishte ngritur sistemi i monitorimit,ndersa nëpunesi autorizues nuk ka informuar me shkrim te pakten ne fund te vitit lidhur me funksionimin e kontrollit te brendshem.

Rekomandim nr.04: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit te informimit dhe monitorimit, si dhe kryerjen e dokumentimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e eficencës se institucionit.

3. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Gjetje nr. 04 Referuar Neni 14 i ligjit nr.152/2015 (Kriteret e pranimit për nivelet në shërbimin e MZSH-së) në germën “b” të pikës 2 të tij ka përcaktuar qartësisht kriterin e arsimimit për punonjësit e nivelit të mesëm, të lartë, që kryejnë funksione, operacionale, inspektuese, apo drejtuese, të cilët janë punonjës me grada, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin e posaçëm nr.152/2015, ndërsa punonjës me funksione të tjera, referuar strukturës së Drejtorisë së Shërbimit të MZSH në Bashkinë Shkodër, ligji i sipërcituar i klasifikon punonjës administrativ, të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës sipas dispozitave të përgjithshme të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

Rekomandim nr. 05 Plotësimi i dosjeve të personelit me gjithë përbërësit sipasorientimeve të VKM nr.117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku pika 1 e këtij vendimi përcakton:

“Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre”.

4. Menaxhimi i buxhetit.

Gjetja nr.05 Ne reference te pikës 263, te udhëzimit Nr.02 DT.06.02.2012 “Për procedurat standarde te zbatimit te buxhetit” duhej te ishte përpiluar dhe miratuar gjurma e auditit për zbatimin e buxhetit, por ka mangësi ne miratimin e përpilimin e gjurmës auditit për zbatimin e buxhetit

Rekomandim nr. 06: Te kërkohej me shkrim, prane Drejtorise Planifikimit buxhetit ne Bashki per te marre asistencen e nevojshme per perpilimin e zbatimin e gjurmës auditit per buxhetin

5. Menaxhimi i të ardhurave.

Gjetja nr. 06 Në referencë tëVKM nr. 285, dt. 27.6.2002, duhej të ishin aplikuar tarifa për të gjithë shërbimet e kryera nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, pasi për një pjesë të shërbimeve nuk janë aplikuar tarifa.

Rekomandim nr.07Nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së të hartohet projekt akti nënligjor per tarifrat dhe shërbimet qe nuk jane te parashikuara ne VKM Nr.285.

Rekomandim nr.08 Dokumenti i Akt-rakordimit me drejtorine e te Ardhurave (mujo dhe vjetor) te protokullohet dhe te miratohet nga Drejtuesi i institucionit.

Rekomandim nr. 09 Formularit te tarifave (sipas llojeve) ti bashkangjiten faturat tatimore, certifikata e zjarrit dhe projektit.

6. Pagat

Gjetje nr. 07 Pagat për punonjësit e MZSH-së, sipas strukturës së miratuar me vendim të kryetares së bashkisë nr.205 dt.19.06.2017 janë dhënë, sipas përcaktimeve të VKM nr.350, datë 19.04.2017, *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ”*, në shkelje të VKM nr.895, datë 21.12.2017, *“Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”* dhe udhëzimit të ministrit, nr. 211, datë 03.04.2017. *“Për përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të vlerësimit të gradave të punonjësve të shërbimit të MZSH-së”*.

Gjetje nr. 08 Pagesat e gradave të reja kanë sjellë një diferencë financiare në mospërputhje me aktet nënligjore në fuqi. Punonjësi në funksionin e drejtorit të MZSH-së, paguhet me gradën “Drejtues Zjarrfikës”, (97000 lek), ndërkohë që mban gradën ”Kryeinspektor” (65000 +6000 = 71000 lek), punonjësi me funksioni Shef Sektori, paguhet me gradën “Komisar Zjarrfikës” (85000 +6000 = 91000 lek). Në total diferenca për periudhën e audituar është në vlerën e 677.374 lekëve. Përgjegjësia për këtë bie mbi punonjësit e drejtorisë juridike, burimeve njerëzore dhe të financës së bashkisë Shkodër

Rekomandim nr.10 Drejtoria e burimeve njerëzore dhe ajo e financës së bashkisë të bëjnë llogaritjet e sakta të diferencave së pagave që rrjedhin nga pagesat sipas gradave të reja, dhënë në mënyrë të paligjshme, të reflektuara nëvendimin e kryetares së bashkisë nr.205, dt.19.06.2017, duke përcaktuar shumat debitore për çdo punonjës dhe afatet e shlyerjes së tyre.

Rekomandim nr.11 Komisioni qëndror i vlerësimit të gradave të punonjësve të MZSH-së në Ministrinë e Brendshme të vlerësojë dhe të kërkojë nga autoritetet përkatëse dhënie gradave për punonjësit e nivelit të mesëm dhe të lartë të shërbimit zjarrfikës të bashkisë Shkodër

7. Shpenzimet për shërbimet e punonjësve jashtë vendit të punës.

Gjetja nr.09 Sipas paragrafit 3 të pikës III dhe pikës V të VKM Nr.997 dt. 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, për punonjësit që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës (mbi 100 km) duhet të autorizohen dhe të miratohen nga titullari i njësisë vendore, ku në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij, si dhe punonjësit në rastin e fjetjes dhe biletat e transportit duhej të paraqisnin faturë të printuar nga kasa elektronike fiskale. Nëpunësi zbatues nuk ka bashkëlidhur në urdhër-shpenzim dokumente që cituam më lart

Rekomandim nr. 12 Në të gjitha rastet e trajnimeve duhet të plotësohet këto dokumente : plan trajnimi, ftesa, programi pjesëmarrjes, lista pjesëmarrësve, fatura tatimore, raporti i pjesëmarrjes të miratuara nga Titullaret e Institucionit

8. Shpenzimet për blerjen e mallrave e shërbimeve me vlerë të ulët.

Gjetje nr.10 Referuar pikave 1,4,5,6,7, neni 40 të VKM nr.914 date 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, drejtuesi i institucionit duhet të planifikojë dhe sqarojë arsyen e kryerjes së shpenzimit, bashkëngjitur specifikimet e mallit ose të shërbimit, të mbajë proces - verbale të testimit të tregut, të përdorë mjetet elektronike për rastet emergjente, si dhe faturat duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit. Nuk janë përpiluar raportet teknike të automjeteve.

Gjetje nr.11 Referuar neni 60 i VKM nr.914 dt. 29.12.2014, “Miratimi i rregullave të prokurimit” Autoriteti Kontraktor duhet të plotësojë formularin e urdhrimit të prokurimit me elementet e cituar: fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare, llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj, dhe emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

Gjetje nr.12 Referuar nenit 2 ligjit 9643 date 22.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë parasysh se përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve ose kandidatëve.

Gjetje nr.13 Referuar nenit 20 të ligjit 9643 date 22.11.2006, “Për prokurimet publike”, i ndryshuar, autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Gjetje nr.14 Referuar nenit 23 te Ligjit 9643 date 20.11.2006 "Për prokurimet publik", i ndryshuar, specifikimet teknike duhet te përcaktojnë karakteristikat e mallrave, duhet të përshkruajnë sa më saktë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm etë hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Gjetje nr. 15 Referuar nenit 24 te Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006"Per prokurimin publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm " për arsye të interesit publik, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës"

Gjetje nr.16 Referuar neneve 42,43 te Udhëzimit nr.30 date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar, titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushë sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Rekomandim nr13:Te planifikohen ,specifikohen dhe preventivohet cdo shpenzim .Kerkesat per shpenzim te analizohen.Per te gjitha defektet e mjeteve te mbahet raport teknik,ne komisionin e vleresimit te ofertave te kete specialist fushe,faturat te firmosen nga gjithë anetaret e komisionit.

Rekomandim nr 14:Ne njesine e prokurimit te kete juriste dhe specialiste fushe sipas objektit te prokurimit. Komisionet e vleresimit dhe marrjes ne dorezim te materialeve te kene perfaqses sipas sektoreve perkates shpenzues te institucionit.

Rekomandim nr. 15: Te behet trajnimi i komisionit te blerjeve te vogla nga specialistet e Njesise Prokurimit prane Bashkisë.

Rekomandim nr. 16: Te gjitha rastet e trajnimeve profesionale duhet te shoqerohen me kerkesa te arsyetuara, me ftesa, me programe, me liste te personave ,te jene te planifikuara dhe te miratuara nga drejtuesit e MZSH-se ,si dhe sipas rasteve nga Titullaret e Bashkise dhe Sekretarit të Përgjithshëm MZSH Tiranë

9. Shpenzimet për investime dhe prokurimi i fondeve me vlerë të lartë

Gjetje nr.17 Referuar nenit 58, VKM 914 dt. 20.11.2006, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është eksperti i fushës.

Gjetje nr. 18 Referuar nenit 2 pika 5.e VKM nr. 914 organi qendror blerës shqyrton specififikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore.

Gjetje nr. 19 Referuar neni 9 VKM nr. 914, vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit.

Gjetje nr. 20 Referuar nenit 34 te ligjit 9643 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e kërkesës për propozim për kontrata me vlerë nën kufirin e ulët monetar. Për këtë përzgjedhje *kërkohen të ftohen të paktën 5 operatorë ekonomikë*, përveç rasteve kur kjo është e pamundur, për arsye teknike ose për mungesë të konkurrencës. Kjo procedurë nuk duhet të përdoret për të shmangur procedurat konkurruese të prokurimit.

Rekomandim nr. 17 Në të gjitha rastet e prokurimeve të kryera nga Organi Qendror blerës, Bashkia, Autoriteti Kontraktor i përfaqësuar nga drejtuesi i MZSH-së duhet :

- Të drejtohet me shkresë “kërkese për prokurim”, nepermjete protokollit.
- Të përpilojë specifikimi dhe preventiva për çdo material dhe shërbim, dokumentacioni të jete i protokolluar dhe i nënshkruar.
- Nje përfaqësues (specialist fushe) I sektorit përkatës të institucionit shpenzues MZSH duhet të jete pjesë e Njesisë së Prokurimit dhe Komisionit të vlerësimit të ofertave.
- Antaret e komisionit të marrjes dorezim të materialeve apo shërbimeve të prokuruar duhet të kenë personel sipas sektoreve përkatës shpenzues të institucionit MZSH.

10. Kontabiliteti dhe raportimi financiar:

Gjetje nr. 21 Normat e harxhimit të karburantit për automjetet zjarrfikëse zbatohen sipas relacionit të komisionit të testimit të automjeteve, mbi bazën e të cilit nuk ka dalë një urdhër i kryetarit të bashkisë Shkodër për ekzekutimin e këtyre normave. Ndezja në vënd e automjeteve bëhet sipas urdhërit të Prefektit të Qarkut, *“Për ndryshimin e orëve të ndezjes së mjeteve zjarrfikëse”*.

Rekomandim nr. 18 Bazuar në relacionin e komisionit të testimit të normave të harxhimit të karburantit, urdhërit të Prefektit të Qarkut nr.____, dt. ____/12/2013, *“Për ndryshimin e orëve të ndezjes së mjeteve zjarrfikëse”*, si dhe kushteve konkrete të gjendjes së automjeteve zjarrfikëse, kryetarja e bashkisë duhet të nxjerrë një urdhër të unifikuar përnormat e harxhimit të karburantit të automjetet zjarrfikëse të bashkisë Shkodër dhe për kohën e ndezjeve në vënd të automjeteve zjarrfikëse të bashkisë

Gjetje nr. 22 Kërkesa për nevojat për karburant, sipas formularit nr. 01 të vendimit të kryetarit të bashkisë nr. 449, dt. 15.17.2016, *“Për miratimin e rregullores për menaxhimin e aktivëve të bashkisë shkodër dhe institucionet të varësisë së saj”*, nuk shoqërohet me një planëzim paraprak

për konsumimin e karburantit, si dhe me një plan pune argument për nevojën e furnizimit me karburant, veçanërisht kjo për automjetin tip “xhip”, Land Rover, që përdoret nga sektori i parandalimit. Përgjegjësini për këto mangësi e ka drejtori i MZSH-së dhe shefi i sektorit të parandalimit.

Rekomandim nr.19 Të bëhet planëzimi paraprak për periudhën vjetore të mbetur për harxhimin e karburantit nga drejtorja e shërbimit të MZSH-së. Kërkesat për nevojën e furnizimit me karburant, nga shefat e sektorëve të bëhen të argumentuara. Punonjësit e sektorit të parandalimit, të lëvizin sipas planit të punës të miratuar nga drejtori i MZSH-së.

Gjetje nr. 23 Drejtori i MZSH-së, sipas formularit nr.03, ka nënshkruar urdhërat e dorëzimit të karburantit pa përcaktuar sektorin, personin përgjegjës për marrjen në dorëzim të karburantit, punonjësin që do të kryej furnizimin dhe për cilin automjet do të shkojë ky karburant. Dalja e lëndës djegëse është bërë nga magazina me fletë dalje, sipas datave të urdhër dorëzimit, dhe i është dorëzuar shefit të sektorit të ndërhyrjes, i cili ka marrë përgjegjësinë e kërkuarit dhe njëherësh të furnizuesit me lëndë djegëse, në kundërshtim me pikën 36 të udhëzimit të Ministrisë së Financave

Rekomandim nr. 20 Në vijimësi, sipas kërkesës për furnizim me karburant, Drejtori i MZSH-së të përpilojë urdhërat e dorëzimit sipas formularit përkatës, ku të saktësohet muaji, sektori për të cilin shkon lënda djegëse, punonjësi që bën tërheqjen, automjeti që do të furnizohet, si dhe punonjësi që do të kryej furnizimin

Gjetje nr.24 Hyrjet dhe daljet e karburantit janë të pasqyruara në librin e magazinës deri në dt.03.10.2017. Prej kësaj date ato pasqyrohen në copa letrash të pamiratuara dhe të pasekretuara. Shifrat e sasisë së hyrje-dalje-mbetje në librin e magazinës shpesh herë janë të koregjuara dhe të palexueshme. Për këtë mban përgjegjësi magazinierja.

Rekomandim nr.21 Të saktësohen të gjitha shifrat e koregjuara në librin e magazinës për hyrje-daljen e karburantit në përputhje me dokumentat shoqëruese të menaxhimit të tij. Të bëhet plotësimi i librit me të gjitha hyrjet dhe daljet e karburantit të bëra gjatë periudhës së mospasqyrimin e në vazhdim.

Gjetje nr.25 Deri në dt. 31.05.2018, konsumi i karburantit pasqyrohet në fletë-udhëtimi në mospërputhje me formatin e lidhjes nr.5/1 të rregullores së miratuar të menaxhimit të aseteve (vendimi i kryetarit të bashkisë nr.449, dt.15.07.2016). Në këto fletë - udhëtimi automjeti, pompat, etj nuk pasqyrohen sipas emërtesës në tabelën e konsumit të karburantit, emërtesë e cila duhet të jetë e njëjtë në të gjitha dokumentet e zinxhirit të menaxhimit të karburantit. Në fletë udhëtime ka korrigjime shifrash të orëve të punës. Ato nuk firmosen sipas rregullave nga

zbatuesi dhe titullari i shërbimit. Përgjegjësinë për këto mangësi e ka shefi i sektorit të MZSH-së dhe drejtori i MZSH-së, i cili nuk ka kontrolluar dhe firmosur fletë - udhëtimet.

Gjetje nr.26 Prej dt. 01.06.2018 e në vazhdim fletët e udhëtimit plotësohen dhe administrohen nga ekonomisti i drejtorisë së shërbimit zjarrfikës. Gjithashtu, po ky punonjës administron kartat elektronike të furnizimit me karburant dhe çelësat e serbatorëve të automjeteve.

Rekomandim nr.22 Përgjegjësi material të bëjë administrimin e sistemit të kartës dhe celsave të mjeteve që mbyllin lëndën djegëse dhe të jetë prezent në momentin e furnizimit. Pas furnizimit të përpilohet fletë daljen, printon nga sistemi veprimin e kryer me kartë në sistem. Flete-dalja dhe raporti sistemit të nënshkruhen nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim.

Rekomandim nr. 23 Fletë udhëtimet të plotësohen nga specialisti i ngarkuar për ndjekjen e lëndës djegëse . Të përdoret formati i fletë - udhëtimet, përcaktuar në Rregulloren e Aseteve të Bashkisë, duke bërë ndryshime në faqen e dytë për sa i përket llojit të konsumit të lëndës djegëse. Emërtesat e automjeteve, pompave, etj. të pasqyrohen sipas emërtesës në tabelën e konsumit të karburantit, emërtesë e cila duhet të jetë e njëjtë në të gjitha dokumentat e zinxhirit të menaxhimit të karburantit. Fletë udhëtimet të plotësohen pa koregjime shifrash. Ato të shkruhen të pastërta dhe të lexueshme. Nëpunësi zbatues, bazuar në urdhër- dorëzimin, daljen e magazinës dhe fletë-udhëtimet, duhet të bëjë verifikimin e rregullshmërisë së konsumit karburantit.

Gjetja nr. 27 Nuk është përpiluar një egjistër i riskut lidhur me menaxhimin e asetëve.

Gjetja nr. 28 Sipas pikave 23.99 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar për mirëmbajtje dhe qarkullim të aktiveve, duhet të përpilohet plan veprimi, në përbërje të komisionit të inventarizimit nuk duhet të jetë anëtar përgjegjësi material, fleta e inventarit duhet të firmosen nga të gjithë anëtarët komisionit. Për këto veprime mbajnë përgjegjësi drejtuesi i institucionit, përgjegjësi financës dhe punonjësi me përgjegjësi materiale

Rekomandim nr.24 Te ngrihet komisioni i nxjerrjes se aktiveve nga perdorimi i perbere jo me pak se 5 persona, per nxjerrjen jashte perdorimit te aktiveve te cilat jane vleresuar jasht funksioni nga komisioni i vleresimit te aktiveve.

Rekomandim nr.25 Për të gjitha lëvizjet e asetëve të lëshohet urdhër dorëzimi

Rekomandim nr. 26 Komisioni inventarizimit nuk duhet te kete me pak se tre persona, te mos kene konflikt interesi, si dhe gjate inventarizimit te jete prezent punonjesi qe ka ne ngarkim materialet.

11. Auditim i zbatimit ligjit nr.152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri e shpëtimin” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij

11.A Auditimi i dokumentacionit të shërbimit të MZSH-së

Gjetje nr.29 Planet e punës, vjetore, mujore dhe ato të stërvitjes plotësohen formalisht. Ato nuk paraqesin, detyra konkrete dhe aktivitetet që do të kryhen, afatet, punonjësit që përgjigjen për zbatimin e çdo aktiviteti, si dhe riskun e zbatimit të tyre. Zbatimi i programeve mujore nuk pasqyrohet në analiza pune, mbi të cilat të hartohen programet pasardhëse të punës. Plane dhe programe pune për përgatitjen e punonjësve të nivelit të mesëm nuk hartohen. Përgjegjësia direkte për këto mangësi e ka drejtori i MZSH-së.

Rekomandim nr.27 Të plotësohet dokumentacioni i planeve të punës mujore nga drejtori i shërbimit për aktivitetin mujor të drejtorisë dhe nga shefat e sektorëve për aktivitetin mujor të sektorëve përkatës. Këto plane të jenë konkrete dhe të pasqyrojnë të gjitha elementët e kërkuara. Në përfundim të çdo muaji të zhvillohen analiza pune, për arritjet mangësitë dhe përgjegjësitë e gjithësejçilit.

Rekomandim nr.28 Të hartohen programet mujore të stërvitjes së punonjësve të të gjitha niveleve, në zbatim të programit vjetor të stërvitjes të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së. Në zbatim të programeve mujore të hartohen programet ditore, ku të pasqyrohen temat që do të zhvillohen, kohën e zhvillimit, kush dhe ku e zhvillon mësimin. Programet të jenë të miratuar në mynyrë hierarkike. Për programet e zhvilluara të bëhen testime dhe të analizohet e dokumentuar ecuria e përgatitjes profesionale të punonjësve

Gjetje nr.30 Plotësimi i dokumentacionit të aktivitetit operacional në disa raste bëhet me mangësi. duke mos pasqyruar realisht aktivitetin e kryer. Për periudhën e audituar janë rreth 26 ditë të paregjistruara në librat e raporteve të zjarreve. Analizat e zjarreve të rëna në pjesën më të madhe nuk kryhen të sakta, pasi në to nuk pasqyrohen me detaje ngjarja, ku, kur, si ndodhi, forcat automjetet dhe mjetet e detajuara që morën pjesë, koha e daljes dhe e kthimit në stacion, ndihmat e dhëna nga forcat e tjera, si u veprua, mënyra, format dhe taktikat e përdorura për ndërhyrje, koha në operacion dhe të tjera detaje rreth operacionit, vlerësime, mangësi të konstatuara, etj. Këto analiza bëhen vetëm nga punonjësit e nivelit bazë pa pjesëmarrjen e shefit të sektorit të ndërhyrjes. Përgjegjësia për këto mangësi e ka shefi i sektorit ndërhyrjes dhe drejtori i MZSH-së , i cili nuk ka ushtruar kontroll për gjetjen

Rekomandim nr. 29 Të pasqyrohet në librin e raporteve të zjarreve aktiviteti operacional për 26 ditët e paregjistruara në këto libra për periudhën 16.10.2016 - 20.04.2018. Në vijimësi analizat e zjarreve të bëhen të plota ku të pasqyrohen të gjitha detajet e operacionit. Në këto analiza të jetë i pranishëm edhe shefi i sektorit të ndërhyrjes, i cili duhet të administrojë librin e analizave të zjarreve

Gjetje nr.31 Në zyrën e informacionit mungon libri telefonik i qytetit dhe ai i titullarëve dhe që vërteton kontrollet dhe masat e marra për mbajtjen e tyre në gatishmëri. Harta e detajuar e drejtuesve të institucioneve në territorin e bashkisë Shkodër. Mungon harta dhe lista e hidrantëve të bashkisë dhe dokumentacioni bashkisë, me rrugët dhe objektet kryesore që përbëjnë rrezik të shtuar për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe planet konkrete përndërhyrje të shërbimit zjarrfikës në këto objekte në raste ngjarjesh mungojnë. Nuk plotësohet pasqyra e punës së automjeteve sipas detyrimit të urdhrit nr.23, dt 16/05/2002. Përgjegjësi për këto mangësi e ka shefi i sektorit ndërhyrjes dhe drejtori i MZSH-së, i cili nuk ka ushtruar kontroll për konstatimin dhe eliminimin e mangësive.

Rekomandim nr. 30 Të kompletohet zyra e informacionit me librin telefonik të qytetit si dhe me listën e numrave të telefonave të titullarëve dhe drejtuesve të institucioneve të bashkisë Shkodër, të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, të bashkive fqinje, etj.

Rekomandim nr. 31 Të plotësohet dosja e hidrantëve me hartën e tyre për të gjithë territorin e bashkisë, duke pasqyruar edhe dokumentacion për kontrollin dhe punën e bërë për mbajtjen e tyre në gatishmëri.

Rekomandim nr.32 Të plotësohet harta e detajuar e bashkisë, me rrugët dhe me objektet kryesore që përbëjnë rrezik të shtuar për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe të hartohen planet paraprake për ndërhyrje të shërbimit zjarrfikës në këto objekte në raste zjarresh.

Rekomandim nr. 33 Të plotësohet pasqyra e punës mujore për çdo automjet, sipas kërkesave të urdhërit nr. 23, dt 16/05/2002. *“Për mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit në shërbimin zjarrfikës”* (lidhja XI), në të cilën të pasqyrohen kilometrat dhe orët e punës së kryer për çdo ditë.

11.B Auditimi i dokumentacionit të inspektim-parandalimit

Gjetje nr.32 Prodhimi, hartimi, administrimi i dokumentacionit Tip, regjistra, procesverbale, relacione, akte teknike, akte të cilat përbëjnë tërësinë shkresore të veprimtarisë të shërbimit të MZSH-së në Bashkinë Shkodër, nuk përmbajnë elementë, si numër serial, nuk administrohen si dokumentacion me vlerë, nuk janë prodhuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik, duke lënë shteg jo formalitetit, spontanitetit. Dokumentacioni i sipërcituar është prodhuar në shkelje të legjislacionit të posaçëm, në kundërshtim me VKM nr.1497, datë 19.11.2008 “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar, me VKM nr.277, datë 06.04.2011 dhe VKM nr.393, datë 18.06.2014. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara kanë ardhur si pasojë e mosnjohjes së akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë dhe disiplojnë dhe ndihmojnë fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Rekomandim nr.34 Drejtuesi i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor duhet të planifikojë, nevojshmërinë e tërësisë së dokumentacionit (modularë tip, regjistra, procesverbale, relacione, akte teknike, të normuara nga aktet nënligjore në fuqi) dhe ta adresojë kërkesën tek Kryetari i Bashkisë, i cili autorizon blerjen e tyre tek Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, në përputhje me legjislacionin e posaçëm, me VKM nr.1497, datë 19.11.2008 “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar, me VKM nr.277, datë 06.04.2011 dhe VKM nr.393, datë 18.06.2014.

Gjetje nr.33 Duke konsideruar dispozitat ligjore parashikuara nga ligji nr.152/2015 “Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin”, i ndryshuar, si dhe nga legjislacioni për planifikimin e territorit në Republikën e Shqipërisë, e specifikisht detyrimet e Kreut V të ligjit të sipërcituar, *“masat për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në projektimin dhe ndërtimin e veprave”*, po ri saktësojmë dokumentacionin tekniko-ligjor që shërbimi i MZSH-së duhet të administrojë pas kërkesës dhe aplikimit të shtetasve, subjekteve fizikë e juridikë, për miratim të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, si dhe për lëshimin e aktit teknik, (deri në miratimin e certifikatës së sigurisë nga zjarri) para vënies në shfrytëzim të objektit.

Rekomandim nr.35 Drejtori i shërbimit të MZSH-së/shefi i sektorit të Inspektimit /Inspektori i parandalimit duhet të pranojnë dokumentacionin tekniko-ligjor të planeve të detajuara vendore, lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit, që shoqërojnë projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.152/2015 “Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin”, si dhe me ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe sipas Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.425, datë 24.07.2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike”.

Gjetje nr.34 Modulari i përdorur si certifikata të mbrojtjes nga zjarri për subjektet kërkuese, nga drejtuesit e shërbimit zjarrfikës, sipas periudhave që kanë qenë të komanduar apo emëruar, nuk janë të miratuara nga ministri përgjegjës, sipas kushtëzimeve të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike”, por nga këta punonjës duhet të ishte vepruar sipas parashikimeve të nenit 55 të ligjit nr.152/2015, ku është kushtëzuar: *“Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001, “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar, zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj dhe shfuqizohen me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji”*.

Rekomandim nr. 36 Modulari i përdorur si certifikata të mbrojtjes nga zjarri për subjektet kërkuese, nga drejtuesit e shërbimit zjarrfikës të mos përdoret më deri në miratimin e projekt udhëzimit të Ministrit përgjegjës për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë, shkallës së ndezshmërisë ndaj zjarrit, procedurat e miratimit, koha dhe mënyra e shqyrtimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e certifikatës të mbrojtjes nga zjarri, por të vazhdohet me dhënien e akteve teknike

Gjetje nr.35: Në dosje nuk gjendet i plotësuar Formularit Informativ të Përgjithshëm. Certifikata e MZSH-së është lëshuar pa verifikuar në terren dhe fotografuar objektin, si dhe nuk është

hartuar relacion me shkrim lidhur me gjendjen faktike të masave pasive, aktive për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në objektin e verifikuar.

Rekomandim nr. 37 Nga Institucioni i Bashkisë Shkodër të merren masa për të plotësuar për çdo rast të administruar Formularin Informativ të Përgjithshëm dhe për çdo dosje individuale të bëhet verifikimi në terren dhe të hartohet relacion me shkrim lidhur me gjendjen faktike të masave pasive, aktive për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në objektin e verifikuar.

Gjetje nr.36 Nga sektori i parandalimit dhe inspektorët e shërbimit të MZSH-së nuk është vendosur asnjë masë administrative (gjobë), lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore të përcaktuara në kreun X (masat për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, në projektimin dhe ndërtimin e veprave, inspektimi) të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

Rekomandim nr. 38 Drejtori i shërbimit dhe sektori i inspektimit të shërbimit të MZSH-së duhet tëveprojnë në përputhje me parashikimet e udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.588, datë 20.10.2016 “Për mënyrën e evidentimit, shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe miratimin e procesverbalit të konstatimit të shkeljes”, si dhe me parimet e legjislacionit të Inspektimit. Drejtorin i shërbimit të MZSH-së duhet të planifikojë ngarkesë ditore për inspektorin e MZSH-së, duke konsideruar veprimtarinë që ushtrohet në objekt/strukturë, distancën e objekteve që do të inspektohen nga stacioni i MZSH-së. Minimumi ditor i ngarkesës së inspektorit por edhe i shefit të sektorit të inspektimit duhet të jetë inspektimi i tre objekteve/aktiviteteve, inspektime që në çdo rast duhet të autorizohen nga drejtuesi i shërbimit të MZSH-së, referuar Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.588, datë 20.10.2016 “Për mënyrën e evidentimit, shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative

**Njësia Auditimit Brendshëm
Bashkia SHKODËR**